


PËRMBLEDHJE

Tryezë Diskutimi: “Ndarja e Përvojave në Reformimin e Policisë”



24 Nëntor 2023

11:00 – 13:00

Rogner Hotel

IDM Albania në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë organizuan tryezën e diskutimit mbi ndarjen e përvojave në reformimin e policisë. Garantimi i pavarësisë së policisë nga politika, integriteti dhe etika policore, efektshmëria e mekanizmave të brendshëm vetërregullues, mbikëqyrja e jashtme e policisë ishin fokusi kryesor i debatit. Ky diskutim bilateral Shqipëri – Kosovë u zhvillua me pjesëmarrjen e Z. Julian Hodaj, Zëvendësministër i Brendshëm në Shqipëri, Z. Mefail Bajqinovci, Deputet i Kuvendit të Kosovës, si dhe përfaqësuesve të Policisë së Kosovës, Policisë së Shtetit, përfaqësuesve të lartë të ministrive përkatëse, agjencive për parandalimin e korrupsionit, agjencive të mbikëqyrjes së policisë, ekspertëve, gazetarëve dhe organizatave të pavarura.

Gjatë diskutimit u theksuan pikat si më poshtë:

Mekanizmat e përzgjedhjes së titullarëve në institucionet e sigurisë të bazohen në konkurrin mbi bazë kriteresh dhe aftësish dhe jo me emërime politike. Zgjedhja e drejtuesve të policisë të jetë e bazuar në konkurrin, në një proces transparent dhe me meritokraci, ku kandidatët e paraqesin vizionin, programin dhe ndryshimet që propozojnë në institucion. Punonjësit e policisë, në këtë mënyrë njihen me kandidatët, vizionin dhe programin e tyre dhe janë më të përbrendësuar dhe bashkëpunues në kryerjen e punëve gjatë zbatimit të programit të kandidatit fitues/drejtuesit të policisë. Po ashtu, drejtori/titullari mban përgjegjësi përpara punonjësve të policisë nëse nuk arrin objektivat e programit të tij. Procesi i zgjedhjes së drejtuesve të lartë të policisë mund të përmirësohet. Praktika e mirë e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit në Kosovë, e cila është në tërësi një proces transparent dhe ka pasur mundësi të ndiqet drejtpërdrejt nga qytetarët mund të zbatohet edhe në përzgjedhjen e drejtuesve të policisë apo të agjencive të mbikëqyrjes policore. Në polici nuk duhet që të kemi emërime, aq më pak, të jetë vetëm njëra palë politike përgjegjëse për emërimet. Drejtuesit e këtij institucioni duhet të zgjidhen me zgjedhje demokratike, transparente, të bazuara në meritokraci, si dhe me pjesëmarrjen e publikut. Ashtu siç u sugjerua zgjedhja e drejtuesit të AMP-se duhet të behet edhe zgjedhja e drejtuesit të policisë. Drejtuesi i policisë, po ashtu edhe drejtuesit e tjerë në strukturat e policisë, nuk duhet të emërohen por të zgjidhen. Nëse kërkohet ndryshimi, atëherë kjo është mënyra e efektshme se si behet ndryshimi, duke filluar që nga titullarët e institucionit në mënyrë që ata të mos jene në presion për shkak

te emërimit. Nëse drejtuesit e lartë të policisë demonstrojnë qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj ndërhyrjeve politike, por edhe nga individët apo grupet kriminalë, këto reflektohen edhe brenda forcës policore.

U evidentua nevoja për fuqizimin e mëtejshëm të mekanizmave të brendshëm të policisë për forcimin e integritetit. Fakti që ka një numër të konsiderueshëm të oficerëve të proceduar në vit në Policinë e Shtetit tregon se mekanizmat qe e brendshëm të këtij institucioni nuk kane qenë mjaftueshëm efektive për të parandaluar këto raste. Prandaj, duhen rishikuar mekanizmat dhe institucionet e kontrollit të jashtëm dhe të brendshëm, të cilat funksionojnë paralelisht me njëra tjetrën. Mekanizmat e jashtëm varen nga mekanizmat efektivë të kontrollit të brendshëm për të ruajtur standardet e profesionalizmit dhe transparencës. Zhvillimi i planeve të integritetit si mekanizma të kontrollit të brendshëm, zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të tyre në nivel njësie policore do të kontribuonte në krijimin e një mjedisi që mbështet kulturën e punës me integritet brenda organizatës policore. Mekanizmat e kontrollit te brendshëm janë me efektive në instalimin e kulturës organizative të punës pro-integritet. Në këtë kuadër, IDM ka asistuar Komisaratin nr. 1 në Tiranë në zhvillimin e planit të integritetit për këtë komisarariat.

Aktualisht Policia e Shtetit është duke zbatuar Planin e Integritetit për Policinë e Shtetit për periudhën 2022-2024. Ky plan, i hartuar nga një grup pune në nivel të DPPSH, adreson problematikat dhe risqet e organizatës policore por jo risqet e integritetit dhe dilemat etike në nivel njësie policore. Angazhimi proaktiv i të gjithë punonjësve të njësisë policore (nëpërmjet fokus grupeve dhe pyetësorëve anonim) në zhvillimin e planit të integritetit, si në rastin e komisarimit nr. 1 në Tiranë, e bën procesin gjithëpërfshirës. Për më tepër, rrit prirjen dhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e zbatimit të masave dhe monitorimin e planit të integritetit, duke qenë se janë ata vetë subjekte të zbatimit të tij.

Nuk mundet një institucion jashtë policisë te njohe problematikat e punonjësve te policisë dhe të identifikojë te korruptuarit brenda policisë. Për më tepër, praktikat e policisë ne Evrope tregojnë ne mase dërmuese agjencitë e mbikëqyrjes policore janë pjese e brendshme e policisë. Fillimisht duhet që vetë institucioni përkatës të forcojë disiplinën brenda tij.

Monitorimi i zbatimit te planeve të integritetit duhet të jetë prioritet për efektshmërinë e tyre. Nga përvoja e deritanishme, është ë rëndësishme investimi gradual te planet e integritetit në nivel njësi policore. Zhvillimi i tyre do të ishte nevojshëm për tre arsye: së pari, kontribuon në ndryshimin e kulturës së menaxhimit të institucionit drejt një menaxhimi të hapur dhe komunikues brenda njësisë policore; së dyti, një rol edukues qoftë për punonjësit e policisë në të gjitha nivelet. Pi kanë shërbyer si një proces për të thelluar njohuritë e tyre mbi këto akte, për të përvetësuar vlerat që ato përcjellin dhe për t'i zbërthyer dhe aktualizuar këto vlera konkretisht nëpërmjet një plani veprimi dhe së

treti, i ndihmon qytetarët të kuptojnë saktësisht se çfarë mund të presin nga njësia policore. Megjithëse planet e integritetit janë shumë të mira, nëse ato nuk gjejnë zbatim atëherë nuk janë të efektshme. Prandaj është i rëndësishëm monitorimi i zbatimit të tyre, nga vetë institucioni por edhe aktorët e tjerë të interesit.

Forcimi i mbikëqyrjes së jashtme të policisë ndihmon në qeverisjen e mirë. Kontrolli demokratik i shërbimeve publike, përfshirë policinë, kërkon që të ushtrohet kontroll nga ana e ekzekutivit, mbikëqyrje nga ana e parlamentit, si dhe kontribut nga ana e shoqërisë civile. Objektivi i përgjithshëm të gjithë aktorëve është që policia të jete ne varësi te ekzekutivit, por te mos keqpërdoret prej tij. Është e pranuar gjerësisht se publiku duhet të ketë kontroll mbi qeverinë dhe shërbimet publike, përfshirë policinë. Kjo është jetike për të siguruar që shërbimet publike t'u përgjigjen nevojave të qytetarëve, dhe policia të mos përfshihet në aktivitete të dëmshme (siç janë veprimet korruptive). Në vendet demokratike, publiku e kontrollon policinë (dhe agjencitë e tjera qeveritare) në mënyrë indirekte, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur (Parlamentit). Një përfaqësues nga media argumentoi se mekanizmat e vetëpastrimit në polici nuk janë të suksesshëm dhe për këtë ka prova nga përgjimet e SKY ECC, ku po tregohet implikimi i përfaqësuesve të policisë në krimin e organizuar.

Përvoja reformatore të Policisë së Kosovës që e bën këtë institucion ndër më të besuarit në vend. Fillimisht, Policia e Kosovës është themeluar nga partnerët ndërkombëtarë të Kosovës në bazë të praktikave të mira ndërkombëtare. Zyrtaret e Policisë së Kosovës janë trajnuar me praktikat më të mira qoftë në hetimin e rasteve qoftë në sjelljen ndaj qytetarëve, menaxhimin e brendshëm, e të tjera. Së dyti, Ministria e Punëve të Brendshme në Kosovë është krijuar gjashtë vjet pas themelimit të Policisë së Kosovës dhe gjatë kësaj periudhe zyrtarët policorë nuk ishin të mësuar që të kenë atë komunikimin apo ndërlidhjen e drejtpërdrejtë me spektrin politik. E treta mbikëqyrja policore, qoftë ajo brenda policisë por edhe kur është themeluar Inspektorati Policor i Kosovës, është krijuar nga partnerët ndërkombëtarë ngjashëm si policia. Pastaj ka qenë edhe baza ligjore mjaft e fortë. Së fundmi, Policia e Kosovës ka qenë gjithmonë e hapur për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe me median.